

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit B.Z., nga P., për shkak të veprës penale zjarrvënia në bashkëveprim nga neni 334 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr159/16 datë 27.04.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.784/2017 datë 05.10.2017, në seancën e kolegjit e mbajtur më datë 17.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit B.Z. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr159/16 datë 27.04.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.784/2017 datë 05.10.2017

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr159/16 datë 27.04.2017, i dënuari B.Z. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale zjarrvënia në bashkëveprim nga neni 334 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14.12.2015 e deri e 10.03.2016 dhe koha e kaluar në arrestin shtëpiak nga data 10.03.2016 e deri me 10.04.2016, pjesën e mbetur të dënimit me burg i dënuari është i

obliguar që ta mbaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Është obliguar i dënuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.784/2017 të datës 05.10.2017, me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të dënuarit e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve të cilin dënim është i obliguar që ta mbajë në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari B.Z, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe i dënuari të shpallet i pafajshëm.

Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.II.nr.33/2018 e datës 09.03.2018, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë i dënuari pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 370 par.6 dhe pika 7 të KPP-së, ngase të dy aktgjykimet janë mbështetur respektivisht në dëshminë e dëshmitarit A.P., por duke mos arsyetuar atë e as provat tjera se pse ja falin besimin apo nuk ja falin besimin në përmbajtjen e tyre si tërsi apo vetëm në një pjesë të tyre. Aktgjykimet po ashtu numërojnë një numër të madh provave por në pjesën e arsyetimit të tyre nuk thuhet asnjë fjalë se cila prej tyre e ka provuar ngjarjen kritike.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e të dënuarit janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Kështu në këtë çështje penalo juridike, dispozitivi i aktgjykimit si dhe aktgjykimi i kundërshtuar është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje juridiko-penale, përshkrimi i dhënë në dispozitiv është i plotë dhe i kuptueshëm, me asgjë të njëjtin nuk e sjell në dyshim. Është bërë përshkrimi i duhur i veprimeve inkriminuese të të dënuarit, por edhe janë dhënë arsyet mbi faktet vendimtare për secilën prej tyre. Në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar janë dhënë arsyet e duhura faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi është i punuar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.6 dhe 7 të KPPK, sepse dispozitat ligjore përkatëse janë respektuar sikurse e parashohin kushtet ligjore. Gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen si të vërtetuara , ka vlerësuar saktësinë e të gjitha provave në këtë çështje penale. Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto konkludimet e veta, të cilat si të drejta i ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së dytë, e të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë se i dënuari e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, kjo është vërtetuar me dëshminë e dëshmitarit A.P., i cili në mënyrë të qartë ka shpjeguar veprimet e të dënuarit, përkatësisht ka elaboruar ngjarjen kritike, duke dhënë detaje të plota, të cilat kanë qenë në lidhmëni reciproke dhe logjike me provat materiale . Ka vërtetuar faktin se ditën kritike ka vërejtur personat të cilët shihen edhe përmes video incizimeve e që njëri prej tyre përputhet me konstruktin e profilit të këtu të dënuarit B. Më pastaj me masat e fshehta të listingut dhe hartografisë, vërtetohet fakti se i dënuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në lokacionin ku gjendet objekti i gjykatës për kundërvajtje aty ku është kryer edhe vepra penale. Kjo vërtetohet në raportin e ZKL nr.3280 e datës 29.12.2015, ku nga antena e Valës vërtetohet edhe koha e dërgimit dhe marrjes së SMS nga numri i cili ka qenë nën vëzhgimin e masës së fshehtë. Më pastaj videoincizimet e siguruara nga kamerat e marketit të lëshuara në gjykatore, lëvizjet e të pandehurit vërtetojnë se personi është i njëjti dhe këtë fakt edhe më tepër e bënë të besueshme çalimi nga ana e të dënuarit .Të gjitha të lartcekurat i bëjnë edhe më të besueshëm edhe SMS-at e nxjerra nga masat e fshehta, ku i dënuari menjëherë pasi që është arrestuar nga ana e policisë dhe atë mu në objektet policore, ka dërguar SMS informues tek zyrtarët e lartë të V... me përmbajtjen “ Me kapën”, jam i arrestum me lëvizjen deri në vetëvendosje”, nga të cilat rezulton se në veprimet e të dënuarit janë formuar

elementet e veprës penale të zjarrvënies nga neni 334 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPPRK.

Nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë rezulton se i dënuari në kërkesë përveç shkeljeve esenciale në pjesën tjetër të kërkesës i referohet dhe fokusohet në elaborimin e çështjeve faktike, pretendime të cilat nuk mund të jenë bazë për këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik konform dispozitës së nenit 432 par.2 të KPPK-së.

Gjykata Supreme vlerëson se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, ndërsa pretendimi i të dënuarit se me aktgjykimet e lartëcekura është shkelur ligji penal në dëm të tij, po ashtu nuk është i bazuar.

Në kërkesë, i dënuari i referohet edhe vendimit mbi dënimin, me pretendimin se gjykata me asnjë provë nuk ka mundur ta vërtetojë faktin se B.Z. është kryes i veprës penale, andaj edhe vendimi mbi dënimin është i pabazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë të dënuarit i ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë vepër penale gjegjësisht dënimin me burgim. Andaj, në rast se nuk është fjala për ndonjë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjyimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërlidhej me mungesën ose paqartësinë të arsyeve lidhur me vendimin për dënimin.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkeljen e ligjit penal dhe shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat në kërkesë pretendohen dhe në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Më 17.05.2018, Pml.nr.49/2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Emine Mustafa

